



FTESË E PËRGJITHSHME E PROGRAMIT (FPP)

“Building Resilience in Individuals and Communities in Kosovo” BRICK

Për Organizatat e Shoqërisë Civile (OShC)

(OShC-të: duke i përfshirë Organizatat Joqeveritare, Shoqatat, Fondacionet dhe organizatat e tjera me bazë në komunitete)

CDF (Fondi për Zhvillim Komunitar) dhe Programi BRICK në Kosovë synojnë të japin grante për organizatat kosovare të shoqërisë civile (OShC) të cilat punojnë vet apo në partneritet me OShC-të e tjera, për të organizuar ngjarje kulturore dhe sportive në rajonin e Kaçanikut.

Data e lëshimit:	22 tetor 2018
Afati i fundit për pyetje:	31 tetor 2018
Data e fundit për dorëzimin e projektit të raundit 1:	21 nëntor 2018
Data e fundit për dorëzimin e projektit të raundit 2:	21 mars 2019
Data e fundit për dorëzimin e projektit të raundit 3:	01 korrik 2019

Programi BRICK:

Ndërtimi i Ripërrirjes tek Individët dhe Komunitetet në Kosovë (BRICK) është një program dyvjeçar që do të zbatohet me nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme në Kaçanik, gjatë periudhës 2018-2019. BRICK është një program për zhvillimin e të rinjve dhe synon t'i zhvillojë shkathtësitë personale dhe profesionale të nxënësve. Qëllimi kryesor i aktiviteteve të programit BRICK është t'i fuqizojë nxënësit dhe strukturat e tyre ekzistuese. Rezultatet e synuara janë për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme që të bëhen më të qëndrueshëm dhe të ndjehen të fuqizuar për të vepruar për të mirën e tyre dhe për t'i tejkaluar sfidat me të cilat përballen. Programi BRICK është themeluar dhe zbatohet nga CDF-ja dhe organizatat e saja partnere.

1. Fusha kryesore e financimit

Mbështetja e ngjarjeve sportive dhe kulturore

BRICK u bënë ftesë OJQ-ve të regjistruara vendore në rajonin e Kaçanikut dhe më gjerë që t'i dorëzojnë aplikacionet për organizimin e ngjarjeve dhe aktiviteteve kulturore dhe/ose sportive duke mos e tejkaluar vlerën prej 4,000 euro mes të periudhës 2018-2019, do të jepen deri në gjashtë grante. Përparësi do t'u jepet OJQ-ve lokale të Kaçanikut, por gjithashtu mund të aplikojnë edhe OJQ-të nga rajone të tjera. Kriteri kyç i përzgjedhjes është cilësia e ngjarjeve ose aktiviteteve të propozuara nga OJQ-të e mundshme.

Qëllimi i këtyre granteve është që të organizohen aktivitete ekstra-kurrikulare (jashtëshkollore) që do ta nxisin talentin dhe kreativitetin e nxënësve drejtpërdrejt të angazhuar, gjë që i shpie në një zhvillim personal dhe profesional, në arsimim dhe në



argëtim. Përveç kësaj, prej OJQ-ve të interesuara pritet që të organizojnë aktivitete ku, përveç angazhimit të nxënësve, duhet ta mbledhin së bashku edhe komunitetin më të gjerë përmes ngjarjeve kulturore dhe sportive, duke luajtur kështu një rol në ndërtimin e një komuniteti më të bashkuar në aktivitete të përbashketa.

Duke e shfaqur vlerën e mbështetjes që komuna e Kaçanikut e vë mbi sportet dhe kulturën në kuadër të komunitetit të vet, këto ngjarje pritet që t'i rrisin mundësitë për socializim për nxënësit dhe banorët e Kaçanikut, duke tërhequr kështu kryesisht audiencat lokale.

Këto evente mund të përfshijnë art, muzikë, festa kulturore ose sport. Ato mund të jenë një seri evente më të vogla ose një event i vetëm, por është esenciale që këto evente t'i bashkojnë nxënësit e shkollave fillore dhe atyre të mesme me komunitetin e Kaçanikut.

Këto evente do të zhvillohen që banorët e Kaçanikut të shohin qytetin e tyre me potencial të ofrimit të mundësive të bashkëpunimit të ndërsjellë.

2. Shuma e financimit, afati kohor dhe kërkesat e përshtatshmërisë

Në përgjithësi, grantet do ti jepen aplikanteve të cilët e paraqesin ndërlidhshmërinë e kostos me arritjen e rezultateve në mënyre të çartë, dhe ndarja e shpenzimeve të jetë në përputhje me ecurinë e mbarëvajtjes së projektit.

CDF përmes Programit BRICK do të ofrojë për organizatat e shoqërisë civile këto grante të vogla, që më shumë fokusohen në arritjet e dukshme sesa në monitorimin e shpenzimeve që janë shfaqur gjatë ekzekutimit të grantit nga ana e përfituesit të grantit. Në përgjithësi grantet jepen aty ku ka siguri në lidhje me koston, kur arritja e rezultateve ose e ngjarjeve tejet të rëndësishme është lehtësisht e dallueshme, dhe kur kostot mund të jenë të ndara sipas arritjeve të dukshme.

CDF përmes Programi BRICK planifikojnë të japin **6 grante** për evente të cilat duhet të organizohen gjatë 12 (dymbëdhjetë) muajve të ardhëm. Organizatave të shoqërisë civile do t'u kërkohet që t'i dorëzojnë idetë konceptuale duke i propozuar llojet e aktiviteteve që do të mbështeten përmes granteve (siç u përmend më sipër) të cilat do të vlerësohen në baza tremujore. Pritet që 5-6 ide konceptuale do të zhvillohen me projekt-propozimet e plota. Rreth 2-3 projekteve do t'u jepen grante në raundin e parë, 2-3 projekteve në raundin e dytë dhe 2-3 projekteve në raundin e tretë (6 projekte gjithsej për FPP).

3. REZULTATET E PRITURA:

- Do të jepen maksimum 6 grante individuale në total;
- Vlera maksimale për një grant është vendosur të jetë deri në 4,000 euro për një ngjarje/event;
- Përmes grantit, OJQ-të mund të organizojnë një event ose një seri ngjarjesh / evente të vogla të ndërlidhura që i arrijnë 500 përfitues;
- Çdo aktivitet apo event duhet të përfshijë nxënësit të shkollave të fillore të larta dhe të mesme në këto aktivitete, dhe në të njëjtën kohë të inkuadrojnë pjesëmarrje më të gjerë të komuniteteve në Kaçanik. Të paktën 15 studentë duhet të angazhohen drejtpërdrejt nga një



OJQ, pavarësisht formatit të ngjarjes (një event i madh që mbahet vetëm një herë ose një seri evente të vogla);

- Çdo aktivitet ose event pritet që t'i mbledhë së bashku të paktën 500 pjesëmarrës (të angazhuar drejtpërdrejt dhe në mënyrë jo të drejtpërdrejt si audiencë);

BRICK nuk do të ndajë më shumë se një shpërblim për një aplikant të vetëm .

Shuma maksimale që BRICK pret t'i japë çdo aplikanti të grantit është deri në 4,000 euro.

Kohëzgjatja e propozuar e projekteve nuk duhet të kalojë më shumë se 3-4 muaj.

4. Kriteret e Grantit për aplikim

Për të qenë minimalisht të përshtatshme për financim, organizatat duhet t'i përmbushin kushtet e mëposhtme:

- Organizatat e shoqërisë civile që përfitojnë grante duhet të jenë të regjistruara në Departamentin për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ-të nën Ministrinë e Administratës Publike të Kosovës. Prandaj, aplikantët duhet ta kenë përfunduar regjistrimin në Departamentin për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ-të.
- Propozimi të jetë në përputhje me objektivat kryesore të BRICK që janë dhënë në listë në seksionin 3

Organizatat e përshtatshme mund të përfshijnë, për shembull, fondacione, shoqata, organizata joqeveritare, organizata/grupe të bazuara në komunitete dhe/ose organizata të grupuara së bashku në një aplikacion si një konsorcium formal apo joformal. Aplikantët duhet të jenë në gjendje të ofrojnë dëshmi të kapaciteteve programore, teknike dhe menaxheriale për kryerjen aktivitetet e synuara, si dhe përvoja në fushat e lartpërmendura.

Një partneritet në formën e një konsorciumi mund të sigurojë një mekanizëm efektiv për rritje të kapaciteteve të përbashketa. Aplikantët inkurajohen që të bëjnë aplikim të përbashkët ose organizime tjera grupore për ta mundësuar pjesëmarrjen e partnerëve të rinj, për ta zgjeruar mbulimin gjeografik dhe për ta përmirësuar potencialin për sukses përmes partneriteteve për ndërtimin e kapaciteteve. Në rastin kur një aplikacion është dorëzuar nga një konsorcium, të paktën njëri partner duhet t'i plotësojë kërkesat e mësipërme të përshtatshmërisë dhe partneri udhëheqës i konsorciumit duhet qartazi të identifikohet.

5. Shuma e pranueshme e Grantit

Madhësia e shumës totale në dispozicion në kuadër të kësaj FPP-je (raundi financues)

është deri në 24,000 EUR. Periudha maksimale e kohëzgjatjes së projektit

është 12 muaj. Buxheti duhet të përgatitet në euro valutë dhe qartazi të bazohet në aktivitetet e përshkruara në aplikacion.

5.1 Aplikacioni Teknik (Aplikacioni i Projektit)

Kjo pjesë e FPP-së përshkruan parametrat për përgatitjen e një aplikacioni të projektit, buxhetin dhe përshkrimin; procesin e aplikimit, vlerësimin e aplikacioneve të pranuar nga BRICK dhe termat dhe kushtet që do të aplikohen për grantet e dhëna.

Formulari i bashkëngjitur i aplikimit duhet të plotësohet në tërësi, së bashku me projektin e propozuar, i cili nuk duhet t'i tejkalojë **3 faqe të shtypura**.



Aplikacionet e pa plotësuar nuk do të konsiderohen për vlerësim.

6. Pakoja e Aplikimit për Grante

Pakoja e aplikimit për grante përmban:

1. Formularin e aplikimit
2. Modelin e buxhetit dhe Udhëzimet e buxhetit (Instruksionet)

7. Vlerësimi i projekt-propozimeve

CDF dhe Programi BRICK do t'i shqyrtojnë aplikacionet dhe më pas në baza të vazhdueshme deri në datën e afatit të fundit siç është cekur më sipër, do t'i përzgjedhë ato që synon t'i financojë në bazë të kërkesave të pikës 3, dhe do të vazhdojë të negociojë një grant me secilin aplikant të suksesshëm, në varësi të fondeve në dispozicion. Vendimi përfundimtar për financim do të bazohet në bazë të rishikimit teknik dhe në disponueshmërinë e mjeteve të BRICK. CDF dhe Programi BRICK rezervon të drejtën për të financuar një ose më shumë apo edhe asnjë nga kërkesat që mund të dorëzohen. Nëse kërkesa bëhet jorelevante për çfarëdo arsye ose financimi nuk është i disponueshëm, CDF dhe Programi BRICK rezervojnë të drejtën për ta mbyllur kërkesën.

Kjo FPP do të jetë e hapur për periudhën nga **22 tetor 2018** deri më **01 korrik 2019**. Afati fillestar për dorëzimin e aplikacioneve është **21 nëntor 2018**. Në atë kohë, të gjitha aplikacionet e pranuar do të merren parasysh në një numër të arsyeshëm, edhe nëse është vetëm një. Aplikacionet e dorëzuara pas këtij afati fillestar do të shqyrtohen deri në fund të periudhës së ardhshme tre-mujore. Të gjithë aplikantët mund t'i nënshtrohen një rishikimi financiar dhe menaxherial para shpalljes së fituesit dhe duhet të dëshmojnë se kanë të vendosur një sistem rigoroz financiar dhe monitorues i cili do të sigurojë sisteme dhe të dhëna të auditueshme.

Afati i fundit për Paraqitje të Pyetjeve – Aplikantët e interesuar mund të parashtrojnë pyetje në lidhje me FPP-në përmes postës elektronike grants@kcdf.org deri më **31 tetor 2018** për raundin e parë dhe deri më **11 mars 2019** dhe **18 qershor 2019** për raundet tjera. Të gjithë aplikantët potencial mund t'i paraqesin pyetjet e tyre në grants@kcdf.org. Pyetjet duhet të parashtrohen më së voni dy javë nga thirrja për propozime. Të gjitha përgjigjet do të adresohen brenda dy ditëve të punës pas pranimit të tyre. Gjatë procesit të aplikimit nuk do të pranohet asnjë kërkesë për takime ose thirrje përmes telefonit me ndonjërin prej pjesëtarëve të stafit të projektit.

Lëshimi i kësaj FPP-je nuk përbën shpallje të fituesit apo detyrim financiar nga CDF-ja dhe Programi BRICK dhe as nuk e detyron projektin që të paguajë për shpenzimet e shkaktuara gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të aplikacionit.



7.1 Fokusimi dhe Prioritetet për Vlerësim dhe Llogaritje të pikëve

Fokusi gjeografik

Fokusi i kësaj FPP-je janë aktivitetet dhe iniciativat në komunën e synuar të BRICK-ut në Kaçanik, prandaj të gjitha aktivitetet duhet të ndodhin vetëm në rajonin e Kaçanikut.

Vendndodhja e përfshirjes së OJQ-ve

Përderisa OJQ-të vendore të Kaçanikut do të kenë përparësi/prioritet gjatë procesit të shpalljes së fituesit për këto grante, theks i veçantë do të vihet mbi idenë dhe cilësinë e vetë ngjarjes së paraparë dhe qëllimit të saj. Prandaj, OJQ-të e regjistruara në rajonet tjera nuk do të përjashtohen nga procesi i aplikimit.

Natyra e ngjarjeve/eventeve

Ngjarjet/eventet mund të jenë një ngjarje/event i madh publik (p.sh. koncert, garë sportive, etj.) ose një seri ngjarjesh/eventesh më të vogla (p.sh. aktivitete në kuadër të shkollave të ndryshme). Për këto të fundit, seritë e ngjarjeve/eventeve të vogla duhet të ndodhin në kuadër të një periudhe kohore prej 3-4 muajsh.

Pjesëmarrësit në ngjarje/evente:

Natyra e ngjarjeve/eventeve duhet të jetë në formën e një ngjarjeje/eventi publik, prandaj numri i audiencës së pritshme për një ngjarje/event duhet të jetë të paktën 500 persona, ndërsa për seri të ngjarjeve/eventeve më të vogla pritet një audiencë prej së paku 200 personash për ngjarje/event. Ngjarja(et) duhet të përfshijnë nxënës të shkollave fillore dhe të mesme si përfitues kryesorë të synuar. OJQ-të potenciale duhet t'i përmbahen Politikës së CDF-ës për Mbrojtjen e Fëmijëve – nëse do të përfshihen të mitur.

Përfituesit e përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejt

Për 15 nxënës që do të përfshihen drejtpërsëdrejti në aktivitetet e planifikuara për një ngjarje/event apo për seri ngjarjesh/organizimesh kërkohet një barazi gjinore. Prandaj, pritet një balancim 50/50 për nxënësit e angazhuar drejtpërsëdrejti.

Ngjarja(et) duhet të përfshijnë jo vetëm nxënës (të nivelit të shkollës fillore dhe të mesme) por ta përfshijnë/angazhojnë edhe komunitetin e gjerë të Kaçanikut (d.m.th., mësuesit, prindërit etj.).

Performanca e aplikantëve në të kaluarën

Gjatë vlerësimit të propozimeve do të merret parasysh performanca në të kaluarën me donatorët tjerë . Organizatat me reputacion të mirë në të kaluarën do të pranohen në mënyrë më të favorshme. Performanca e dobët apo keqpërdorimi i fondeve nën projektet e donatorëve tjerë do të vlerësohen me pikë negative. Të gjitha aplikacionet që do të shqyrtohen për financim do të verifikohen nga CDF për programin BRICK.

7.2 Metoda e vlerësimit dhe kriteret

Të gjitha aplikacionet që i përgjigjen në mënyrë të qartë pikave kryesore të kësaj FPP-je do të vlerësohen në baza konkurruese (sistemi i pikëve) në përputhshmëri me kriteret e paraqitura më poshtë të përcaktuara nga programi BRICK dhe anëtarët e organizatave të tij partnere. Këto kriteret janë zhvilluar për t'i adresuar synimet e caktuara të Programit BRICK. Numri i pikëve të caktuara tregon rëndësinë përkatëse të secilit faktor. Për ta bërë procesin e vlerësimit sa më objektiv që është e mundur, secili aplikant duhet që qartazi të demonstrojë se si aplikacioni i tij/saj i plotëson kriteret e mëposhtme.

Kriteret e Përshtatshmërisë në mënyrë që aplikacioni të vlerësohet për mbështetje

Kriteret e Përshtatshmërisë	PO	JO
OShC-ja është e regjistruar me Departamentin e OJQ-ve.	PO	JO
A është propozimi në përputhshmëri me objektivat e BRICK dhe FPP-së? <ul style="list-style-type: none"> ▪ Do të jepen maksimum 6 grante individuale në total; ▪ Vlera maksimale për një grant është vendosur të jetë deri në 4,000 euro për një ngjarje/event; ▪ Përmes grantit, OJQ-të mund të organizojnë një event ose një seri eventesh të vogla të ndërlidhura që i arrijnë 500 pjesëmarrës; ▪ Çdo aktivitet apo ngjarje duhet të përfshijë 15 nxënës të shkollave të fillore të larta dhe të mesme në këto aktivitete, dhe në të njëjtën kohë të inkuadrojnë pjesëmarrje më të gjerë të komuniteteve në Kaçanik 	PO	JO

Nëse propozimi nuk e përmbush ndonjërin prej kriterëve të përshtatshmërisë, atëherë ai nuk do të vlerësohet dhe nuk do t'i llogariten pikët.

Kriteret me vlerësim përmes pikëve

Tabela e vlerësimit	Pikët
<p>Shpjegimi/ Arsyeshmëria e projektit</p> <p><i>Aplikacioni duhet i çartë dhe i arrësyeshëm mirë. 10%</i></p>	10
<p>Përshkrimi i projektit dhe fizibiliteti,</p> <p><i>Aplikacioni do të vlerësohet për masën dhe cilësinë në të cilën aplikanti demonstroi qasje të arsyeshme ndaj projektit, burime të mjaftueshme për ta përfunduar projektin dhe aftësinë për ta përfunduar projektin në kohë. Do të shqyrtohet plani i punës për veprimet e hollësishme dhe një plan i punës për implementimin e komponenteve përbërëse të aplikacionit. Planet e qarta, logjike, reale dhe efikase do të rezultojnë me pikët më të larta. 15%</i></p>	15
<p>Qëndrueshmëria, rezultatet dhe përfitimet e projektit</p> <p><i>Aplikacioni do të vlerësohet për ta përcaktuar në çfarë mase rezultatet e pritura të projektit e arrijnë qëmmimet e pritura të FPP. Aplikacioni do të vlerësohet për të përcaktuar nëse aplikanti i ka përfshirë masat e performancës së bazuar në rezultate dhe nëse projekti do të arrijë rezultate të qëndrueshme përtej kohëzgjatjes së projektit. 20%</i></p>	20
<p>Objektivat e synuara të projektit dhe përfituesit/komunitetet</p> <p><i>Aplikacioni do të vlerësohet për t'i përcaktuar lidhjet me objektivat e planifikuara dhe grupet e synuara 20%</i></p>	20
<p>Kapaciteti organizativ, personeli dhe përvojat në të kaluarën</p> <p><i>Aplikacioni do të shqyrtohet për të përcaktuar nëse aplikanti ka kapacitet për ta implementuar projektin dhe nëse personeli kyç i ka njohuritë, aftësitë dhe mundësitë e duhura për kontrollim të fondeve, menaxhim të granteve, monitorim dhe vlerësim të performancës apo aktivitete tjera relevante për suksesin e programit të propozuar. 15%</i></p>	15
<p>Pjesa financiare/ Efikasiteti dhe arsyeshmëria e kostove buxhetore</p> <p><i>Buxheti do të shqyrtohet për plotësi dhe ndërlidhje me aktivitetet dhe rezultatet e propozuara 20%</i></p>	20
PIKËT TOTALE	100

8. Procedura e aplikimit

Aplikantëve të interesuar u kërkohet të plotësojnë Formularin e Aplikimit për Grant me të gjitha shtojcat përkatëse të cilat mund:

- a. të shkarkohen në web faqen e CDF-së: <http://www.kcdf.org/BRICK>
- b. të kërkohen përmes postës elektronike në grants@kcdf.org



Ditët e informuese me aplikantë potencialë do të organizohen si në vijim:

1. Për raundin e parë: Salla e Kuvendit Komunal, Kaçanik më 29 Tetor, 2018 në 10:00

CDF/BRICK nuk është përgjegjës për asnjë shpenzim që lidhet me zhvillimin e aplikimit.

9. Afati i fundit për dorëzim

Tre thirrje për propozime do të jenë në dispozicion për periudhën 2018-2019 dhe propozimet duhet të dorëzohen në gjuhën shqipe ose angleze. Përderisa OJQ-të mund t'i dorëzojnë aplikacionet e tyre në të trija thirrjet për propozime, asnjë OJQ nuk do të fitojë grant më shumë se një herë. Të gjitha propozimet duhet të dorëzohen deri në ora 16:00 në këto data:

Thirrja e parë: 21 nëntor 2018

Thirrja e dytë: 21 mars 2019

Thirrja e tretë: 01 korrik 2019

Aplikantët duhet ti dërgojnë kopje elektronike te propozimit në formatin Word dhe Excel, **grants@kcdf.org**.

Të gjitha aplikacionet e pranuar nga ana e CDF-it do t'iu kethehet email vërtetim i pranimit te propozimit.

Të gjitha aplikacionet duhet:

- Të dorëzohen në formatin e kërkuar me të gjitha dokumentet e kërkuara të bashkëngjitura (Formularin e plotë të aplikimit, buxhetin, një kope e çertifikatës së regjistrimit, numrin fiskal)
- CDF nuk do ta kthejë asnjë aplikacion të dorëzuar.

Aplikantët do të informohen për statusin e aplikacionit të tyre dhe shpalljen e granteve përmes e-mail adresave të ofruara në formularin e tyre të aplikimit.

10. Dokumentet për t'i verifikuar kriteret e përshtatshmërisë

Të gjitha pakot e aplikimit, përveç formularëve të kërkuar, i përmbajnë dokumentet e mëposhtme:

1. Kopjen e regjistrimit në Departamentin për Regjistrime dhe Ndërlidhje me OJQ-të në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike të Kosovës.
2. Çertifikatën e nënshkruar të gatishmërisë për t'i ndarë deklaratat financiare në përputhje me rregulloret e CDF-ës nëse kërkohet një gjë e tillë.



Për ta shkarkuar pakon e aplikimit, ju lutemi shihni shpalljen e FPP-së në www.kcdf.org/BRICK

Shtojcat

Shtojca 1: Formulari i plotë i aplikimit për Projekt Propozim

Shtojca 2: Formulari i plotë i buxhetit për Projekt Propozim